



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 10 prot.

Kamëz, më 24. 1. 2025

V E N D I M
Nr. 10 .Datë 24 / 1 2025
MBI

“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE GJATË VITIT 2025 PËR FAMILJET QË NUK JANË PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT, TË CILAT DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE” DHE “TRAJTIMIN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA BUXHET I BASHKISË KAMËZ PËR VITIN 2025”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 24.01.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.04 Datë 20.01.2025 në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr.57 datë. 18/07/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë neni 21, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.597 datë. 04/09/2019 kreu 4 pika 3, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, vendimit nr.617 datë 22.09.2022, vendimin 855, datë 26.12.2024 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" neni 4, neni 5, neni 6 të Ligjit nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 119 datë 19.12.2024 " Mbi miratimin e Projekt-Buxhetit afat mesëm të Bashkisë Kamëz (PBA)" për vitin 2025, 2026, 2027 , **Këshilli Bashkiak Kamëz**";

V E N D O S I:

1- Miratimin e kriterëve për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit të cilat do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike", si dhe trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve në nevojë, fëmijë me status jetimi, të moshuar të vetmuar nga buxheti i bashkisë, vijon si më poshtë;

- a. Familjet të cilat jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme, në banesa të papërshtatshme dhe pa të ardhura.
- b. Familjet që janë të varfëra, të cilat kanë fëmijë nën 16 vjeç në përbërjen e tyre familjare dhe nuk kanë anëtarë madhorë në punë.
- c. Gra kryefamiljare, të cilat mund të jenë të ve-ja, të divorcuara ose në proces divorci me të ardhura të pamjaftueshme për jetesë.
- d. Familjet që kanë në përbërjen e tyre fëmijë të mitur në konflikt me ligjin, probleme dhune në familje, kryefamiljarë që vuajnë dënimin me heqje lirie, të cilat janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe të ardhura të pamjaftueshme.
- e. Familje me dy anëtarë të moshuar, apo të vetmuar pa të ardhura të mjaftueshme për jetesë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

- f. Familje me anëtarë mbi moshë aktive për punë, por që nuk janë përfitues nga skema e sigurimeve shoqërore për pension pleqërie dhe nuk kanë anëtare të tjerë në familje për orientim drejt tregut të punës.
- g. Familje me anëtarë të paaftë për punë, por që ligjërisht nuk janë përfitues nga skema e PAK, anëtarë të familjes që kanë krijuar varësi nga alkooli, droga etj.

Kohëzgjatja e qëndrimit në skemë do të jetë e limituar në kohë dhe e kushtëzuar me vlerësimin social-ekonomik për ndryshimin e kushteve të jetesës.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI**

